

VENDIM
Nr. 10, datë 27.3.2026

**PËR ANËTARËSIMIN E BANKËS JET SHA NË SKEMËN E SIGURIMIT TË
DEPOZITAVE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR SIGURIMIN E
DEPOZITAVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të nenit 22, pika 5 dhe pika 6 të nenit 23, dhe të nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar; të nenit 22 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7, pika 2 dhe pika 3, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar; të nenit 7, pika 4, të nenit 9, pika 3, të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018; të nenit 6/1, shkronja “e”, të rregullores nr. 20, datë 25.9.2017, “Për nënshkrimet e autorizuar në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31, datë 10.10.2025, “Për caktimin e z. Martin Blushi, zëvendësdrejtor i përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm”; të nenit 18; pika 2, të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 3.11.2014, si dhe me propozim të zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e Bankës Jet sh.a. në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.

2. Autorizohet kryetari i Këshillit Drejtues dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm për nënshkrimin e certifikatës për sigurimin e depozitave në Bankën Jet sh.a.

3. Autorizohet zëvendësdrejtori i përgjithshëm për njoftimin e Bankës Jet sh.a. për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave, si dhe të informojë Autoritetin Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohet Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Donald Duraj